



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 18 datë 29.4.2024**

**“PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2024 E MIRATUAR ME “VENDIMIN E  
KËSHILLIT BASHKIAK NR.55 DATË 29.12.2023 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË  
VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2024 –  
2026 TË BASHKISË SHKODËR”**

Këshilli i Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e datës 29.4.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, neni 54 shkronja “dh” i ndryshuar; ligji nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, VKM nr.414 datë 08.07.2021 “Për miratime procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondeve të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile” i ndryshuar, neni 3,3.1, gërmat a,b,dh, ligji nr.68/2017 “Për financat vendore” i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar ; shkresës nr.4461/2 prot. datë 20.02.2024 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” të Ministrisë së mbrojtjes, Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”; shkresës nr.3680/1 prot. datë 23.02.2024 “Kthim përgjigje Ministrisë së Mbrojtjes, Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile te shkresës me nr. 446/2 prot. datë 20.02.2024 me objekt “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” nga Bashkia Shkoder ; shkresës nr.3806/1 datë 29.03.2024 prot. “Dërgohet miratimi për shpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile viti 2024” të Ministrisë së Financave ”VKB nr. 55 , datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër“ , i ndryshuar

**V E N D O S I:**

I. Të miratojë shtesën e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2024 alokuar në programin 10910 “ Emergjencat Civile “ prej **22,879,560** lekë si më poshtë:

1.Për kod produkti 91707AG – “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe

shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve” me vlerë **10,000,000 lekë**.

2.Për kod produkti 91707AB – “Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme” me vlerë **12,879,560 lekë**.

II. Të miratojë shpenzimet për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve” me kod produkti 91707AG me vlerë **10,000,000 lekë** si më poshtë:

1-“Shërbime emergjente për riparimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturë si rezultat i fenomeneve natyrore” me vlerë **2,000,000 lekë**

2-“Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të Qytetit dhe Njësi Administrative, Bashkia Shkodër” me vlerë **4,000,000 lekë**

3-“Blerje materiale inerte për mbrojtjen e argjinaturave dhe infrastrukturës nga fenomeneve natyrore” me vlerë **1,000,000 lekë**.

4- “Blerje material për riparimin e të urave në Njësi Administrative me vlerë **500,000 lekë**.

5-“Blerje koncentrat për blegtorinë” në shumën **2,500,000 lekë**.

III.Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

IV.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**

**Oltion LULI**



Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Denis Lesha**

Miruar me 29 vota  
Vota Pro 29  
Vota Kunder 12  
Vota Abstenim 0  
Zbardhur me datë 7.5.2024